



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 1 Datë 05. 09. 2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË RINOVIMIT TË LEJES  
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE “

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 gërma b; nenit 41, nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore“ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

V E N D O S I :

1-Të miratojë kërkesën e subjektit “COLACEM ALBANIA” sh.p.k. me administrator Z.Gaetano CAFARO për rinovim të lejes së përdorimit të burimit ujor **Pus shpimi** si ujë teknologjik për fabrikën e çimentos me vendndodhje në fshatin Balldren,Njësia Administrative Balldren, Bashkia Lezhë , Qarku Lezhë.

Koordinatat e pusit të shpimit: X -46 34 445.8; Y -43 86 592; Z – +5 m;

Thellësia e pusit : 26 m;

Diametri i pusit: 200mm

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 4.5 l/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI

KRYETAR

Paulin RADOVANI

